

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI PARASHKOLLOR



PUNIM DIPLOME

Kaltrina Lahu

Mitrovicë, 2020

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI PARASHKOLLOR



PUNIM DIPLOME

**Tema: METODAT EFEKTIVE TË MËSIMNXËNIES
SË GJUHËS ANGLEZE NE EDUKIMIN PARAFILLOR
NË KOMUNËN E VUSHTRRISË**

Mentorja: Prof. Edita Bekteshi

Kandidatja: Kaltrina Lahu

Mitrovicë, 2020

UNIVERSITY OF MITROVICA “ISA BOLETINI”

FACULTY OF EDUCATION

PRESCHOOL PROGRAM



DIPLOMA PAPER

**Topic: EFFECTIVE METHODS OF TEACHING
ENGLISH IN PRESCHOOL EDUCATION IN THE
MUNICIPALITY OF VUSHTRRI**

Mentors: Prof. Edita Bekteshi

Candidate: Kaltrina Lahu

Mitrovicë, 2020

UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI PARAFILLOR



PUNIM DIPLOME

Lënda: Gjuhë Angleze

Titulli i punimit: Metodat efektive të mësimnxënies së gjuhës angleze në edukimin parafillor në komunën e Vushtrrisë

Emri dhe mbiemri: Kaltrina Lahu

Statusi i studentit: I rregullt

Numri i amzës(ID Regjistri): 1506021042

Niveli i studimeve: Bachelor

Programi i studimit: Parafillor

Mentori/ja i/e punimit: Prof. ass. dr. _____

Aprovuar prej komisionit:

1. _____, mentor
/Emri Mbiemri, Titulli /
2. _____, anëtar
/Emri Mbiemri, Titulli /
3. _____, anëtar
/Emri Mbiemri, Titulli /

Data e aprovimit: _____

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, Kaltrina Lahu deklaroj se ky punim diplome i nivelit bachelor me titull “Metodat efektive të mësimnxënies së gjuhës angleze në edukimin parafillor në komunën e Vushtrrisë” është puna ime origjinale dhe nuk është prezentuar para ndonjë universiteti tjetër.

Ky punim nuk është kopjuar nga asnjë punim i studentëve të tjerë apo nga ndonjë burim tjetër, përveq atyre burimeve të cituara në mënyrë të rregullt të cilat i kam përmendur te referencat.

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Data, Vendi

DEDIKIMI

*Këtë punim diplome ia dedikoj prindërve të mi,
që kanë qenë gjithëmonë mbështetja dhe motivi im në këtë rrugëtim.*

FALENDERIME

Në radhë të pare jam shumë falenderuese ndaj Zotit i cili më dha shëndetin dhe fuqinë ta përfundoj këtë punim e pastaj falenderoj të gjithë ata të cilët kontribuan në një mënyrë ose tjetër në këtë punim. Gjithashtu, një falenderim i madh shkon gjithashtu për mentoren e këtij punimit Prof.Ass. Dr. Edita Bekteshi për udhëheqjen dhe punën e palodhur deri në mbarimin e punimit. I jam mirënjohëse për mbështetjen, kurajon dhe përkushtimin që ka treguar gjatë këtij punimi.

Falenderoj edhe të gjitha mësueset e shkollave të qytetit të Vushtrisë të cilat më ndihmuan ta realizoj punimin dhe stafin e Universitetit të Mitrovicës.

Ndërsa për fund falenderoj më së shumti dhe u jam shumë mirënjohëse familjes sime nga të cilët kisha mbështetjen më të madhe gjatë gjithë këtyre viteve si studente, e në veçanti prindërit e mi të cilën nuk kursyen as edhe një moment së qenuri pranë meje në hapat më të rëndësishëm të jetës sime.

Ju jeni motivi im kryesor në cdo rrugëtim.

LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE

Tabela 1. Numri dhe Përqindja e Pjesëmarrësve Sipas Moshes, Gjinisë dhe Vendbanimit	13
Tabela 2. Numri dhe Përqindja e Pjesëmarrësve Sipas Shkollës në të Cilën Punojnë dhe Sipas Shkollim.....	15
Tabela 3. Mesi Aritmetik dhe Devijimi Standard sipas Vendbanimit dhe Variablës së Pjesëmarrjes në Trajnime të Ndryshme në Gjuhën Angleze.....	16
Tabela 4. Mesi Aritmetik dhe Devijimi Standard midis Vendbanimit dhe Lloj-llojshmërisë së Metodave Brenda një Aktiviteti.....	17
Tabela 5. Mesi Aritmetik dhe Devijimi Standard midis Moshes dhe Pjesëmarrjes në Trajnime të Ndryshme në Gjuhën Angleze	17
Tabela 6. Mesi Aritmetik dhe Devijimi Standard midis Përvojës së Punës dhe Metodës së Bashkëpunimit.....	18
Grafiku 1. Shpërndarja e numrave dhe përqindjeve sipas gjinisë, moshes dhe vendbanimit..	14
Grafiku 2. Shpërndarja e numrave dhe përqindjeve sipas emrit të shkollës dhe nivelit të shkollimit	15

LISTA E SHKURTESAVE

ECEC- Education Care Early Childhood- Edukimi i Kujdesit të Fëmijërisë së Hershme.....	2
KETNET-Kosovo English Teacher’s Network- Rrjeti i Mësuesve Anglisht në Kosovë	3
CL- Coperative Learning- Qasja e Mësimit Bashkpunues.....	4
TPR- Total Physical Response- Përgjigjja Totale Fizike.....	7
SPSS- Pako Statistikore e Shkencave Sociale.....	12
EMI- Mediumi i Udhëzimit.....	21

Abstrakti

Pasi e dimë se mësimi i një gjuhe të dytë si gjuhës angleze është bërë një domosdoshmëri, ajo gjithashtu ndihmon në pasurimin e trurit të njeriut dhe në lehtësimin e komunikimit në vende të ndryshme të botës atëherë qëllimi i këtij punimi është të zgjedhë qasjen më të mirë dhe më të përshtatshme për mësimin e gjuhës angleze te fëmijët si gjuhë e dytë në arsimin parashkollor.

Hulumtimi është zhvilluar në pesë shkolla të qytetit të Vushtrrisë, ku popullate ishin kryesisht mësueset të cilat punojnë me fëmijët e moshave 5-6 vjeq të cilët ndjekin kurse private, ndërsa si mostër e kësaj popullate u zgjodhën 11 mësuese. Instrumenti është i përshtatur nga “The Teachers Educational Practices Questionares (Maria G. Catalano., Perucini P., & Vecchio M. Gjovani., 2015).

Analizat statistikore janë: analiza përshkruese, T-testi dhe Anova, dhe të dhënat janë përpunuar nga Pako Statistikore e Shkencave Sociale (SPSS) –versioni 2020.

Në bazë të të dhënave të nxjerra nga pyetsori atëherë gjetjet tregojnë se të gjitha mësueset pajtohen se metoda bashkëpunuese është më efektive se sa metoda individuale dhe se mësueset të cilat jetojnë në qytet shprehin interes më të madh të marrin pjesë në trajnime të ndryshme të gjuhës angleze dhe të praktikojnë lloj-llojshmëri të metodave gjatë një aktiviteti.

Që të jetë i suksesshëm angazhimi me fëmijët për të mësuar një gjuhë të dytë në fëmijërinë e tyre të hershme atëherë është e rëndësishme edhe që zotërimi i metodologjive të atij mësuesi të jenë adekuate me moshën e fëmijëve.

Fjalët kyce: Metodatat efektive, mësimnxënia, fëmijët, gjuha angleze

Abstract

Since we know that learning a second language like English has become a necessity, it also helps to enrich the human brain and facilitate communication in different parts of the world then the aim of this paper is to choose the best approach and more suitable for teaching English to children as a second language in preschool education.

The research was conducted in five schools in the city of Vushtrri, where the population were mainly teachers who work with children aged 5-6 years who attend private courses, while as a sample of this population were selected 11 teachers. The instrument is adapted from The Teachers Educational Practices Questionnaires (Maria G. Catalano., Perucini P., & Vecchio M. Gjovani., 2015).

Statistical analyzes are: descriptive analysis, T-test and Anova, and data were processed by the Statistical Package of Social Sciences (SPSS) - 2020 version.

Based on the data extracted from the questionnaire then the findings show that all teachers agree that the collaborative method is more effective than the individual method and that teachers who live in the city express a greater interest in participating in various English language trainings. and practice a variety of methods during an activity.

For successful engagement with children to learn a second language in their early childhood then it is also important that mastery of that teacher's methodologies be appropriate to the age of the children.

Keywords: Effective methods, learning, preschool children, English language

PËRMBATJA

Deklarata e autorësisë	V
Dedikimi	VI
Falenderime.....	VII
Lista e tabelave dhe figurave	VIII
Lista e shkurtesave.....	IX
Abstrakti.....	X
1.0 Hyrje	1
1.1 Metoda të mësimdhënies së gjuhës angleze nga vende të ndryshme.....	1
1.2 Roli i mësuesit në mësimdhënien e gjuhës angleze	4
1.3 Llojet e metodologjive të gjuhës angleze te fëmijët parashkollor.....	4
1.3.1 The silent way method.....	5
1.3.2 The community language learning.....	5
1.3.3 The direct method	5
1.3.4 Metoda “the audio-lingual”.....	5
1.3.5 Metoda “suggestopedia”	5
1.3.6 The communicative language teaching method (clt)	5
1.3.7 Metoda “the immersion”.....	5
1.3.8 The correction methods.....	6
1.3.9. Çka është metoda tpr?.....	7
1.4 Rëndësia e lojrave te fëmijët	8
1.5 Faktorët e fëmijëve për të mësuar një gjuhë të dytë.....	9
1.6 Avantazhet e mësimit të hershëm të gjuhës	9
1.7 Rëndësia e motivimit gjatë mësimit të gjuhës angleze	9

2.0. Metodologjia	11
2.1. Dizajni i hulumtimit	11
2.2 Pjesëmarrësit	11
2.3 Instrumentet.....	11
2.4 Mënyra e mbledhjes së të dhënave.....	12
2.5 Analizat	12
2.6 Aspekti etik	12
3. Rezultatet	13
4.0. Diskutime.....	19
5.0. Konkludime dhe rekomandime.....	20
Literatura.....	22
Shtojcat	25
Shtojca A.....	25

1.HYRJE

Mësimi është aftësia për të ndryshuar sjelljen si rezultat i përvojës individuale në atë mënyrë që sjellja e re të përshtatet më mirë me kushtet e ndryshuara të mjedisit (Menzel, 2013). Gjithashtu edhe mësimi i një gjuhe të huaj ka rëndësi në shoqërinë e sotme. Është një trend mbarëbotërorë në shekullin e tanishëm për të ulur moshën e mësimin të gjuhëve të huaja të fëmijëve, dhe tani është e zakonshme që fëmijët të fillojnë të mësojnë një gjuhë që nuk është gjuha e tyre amtare edhe para se ata të fillojnë arsimin e tyre zyrtar fillor, në moshën nga 0 në 7 (Murphy & Evangelou, 2016). Prandaj, si i tillë, duke u nisur nga fakti se gjuha angleze është një gjuhë e dëshiruar nga familjet kosovare, dhe se prindërit angazhohen që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në kurse që në fëmijërinë e hershme ky punim synon të analizojë metodat e mësimdhënies së gjuhës angleze që aplikohen tek fëmijët e moshës parashkollore.

1.1 Metoda të mësimdhënies së Gjuhës Angleze nga vende të ndryshme

Si gjuhë globale, me numrin më të madh të folësve në të gjithë botën (llogaritur në 1.5 miliardë, prej të cilëve vetëm 375 milion janë folës amtare¹), Gjuha Angleze tani mbizotëron si gjuhë e huaj në shkolla në të gjithë botën (Garton, Copland, dhe Burns , 2011). Gjithashtu edhe kurrikulat parashkollore po ndjekin gjithnjë e më shumë këtë trend, dhe në disa vende evropiane si Spanja, Qipro dhe Polonia, anglishtja është zyrtarisht pjesë e kurrikulës parashkollore (Murphy & Evangelou, 2016).

Kontekstet në të cilat Gjuha Angleze u mësohet fëmijëve ndryshojnë shumë (Cameron, 2003). Gjuha Angleze gjithashtu mësohet si gjuhë e dytë për fëmijët jo anglisht-folës në kopshte në vende si India ose Hong Kongu, ku është gjuha zyrtare dhe gjuha e arsimit të lartë. Por, në shumë pjesë të botës Gjuha Angleze nuk ka ndonjë rëndësi të menjëhershme për fëmijët, dhe për këtë arsye mësohet si gjuhë e huaj, zyrtarisht dhe joformalisht. Ky është rasti edhe i Serbisë, ku Gjuha Angleze nuk është pjesë e kurrikulës zyrtare parashkollore, por shpesh u mësohet grupeve të ndryshme të moshës parashkollore.

Në Indi, qëllimi i programeve parashkollore, të ofruara vetëm në sektorin privat, është që të përfitojnë nga aftësia e fëmijëve për të marrë një besueshmëri natyrore në qoftë se ata kanë

mundësinë për të filluar mësimin e Gjuhës Angleze qysh në fillim të jetë e mundur, dhe kështu të sigurohet një status më i mirë shoqëror dhe arsimim dhe mundësi punësimi - (Shankar & Gunashekar, 2016).

Studimet kërkimore që janë kryer në Kanada me arsim të hershëm të mësimin kanë treguar se ata fëmijë që janë dygjuhësh zhvillojnë konceptin e qëndrueshmërisë së objektit më shpejt sesa ata që nuk e bëjnë këtë. Me fjalë të tjera, ata mësojnë se objektet që kanë një emër tjetër në një gjuhë tjetër mbeten të njëjta pa marrë parasysh atë që quhet dhe se funksioni i objektit nuk ndryshon. Ai gjithashtu u jep fëmijëve fleksibilitet më të mirë mendor dhe aftësi të të menduarit krijues sesa homologët e tyre që flasin vetëm një gjuhë. Megjithatë ka pasur përhapje të kërkimeve për mësimin e gjuhës angleze tek parashkolloret, ai mbetet një i nënvlerësuar në mbarë botën. Sidoqoftë, studimet më të fundit po hedhin më shumë dritë në këtë fushë të rëndësishme të mësimin të gjuhës së fëmijëve. Këto studime merren me çështjet e faktorit të moshës në mësimin e gjuhës angleze në mjediset e Edukimit dhe Kujdesit të Fëmijërisë së Hershme (ECEC), cilësimet (Murphy and Evangelou, 2016), llojin e ekspozimit, sfidat e arsimit dygjuhësh, kualifikimet e mësuesve, disponueshmërinë e burimeve, etj. roli i prindërve, zhvillimi i kurrikulës, afërsia e metodave dhe qasjeve të aplikuara, dhe motivimi dhe qëndrimi i nxënësve. Një përmbledhje nga Melhuish et al. (2015) për kujdesin e fëmijëve dhe arsimin parashkollor (d.m.th. ECEC) ka pohuar edhe një herë rolin kryesor në të cilin luan arsimi parashkollor, zhvillimi i fëmijëve, veçanërisht për ata me prejardhje të pafavorshme që hyjnë në shkollë me më pak aftësi akademike se sa bashkëmoshatarët e tyre më të avantazhuar, dhe ata shpesh mbeten prapa në zhvillimin e tyre njohës gjatë viteve të mëvonshme shkollore (Stipek dhe Ryan, 1997). Melhuish duke thënë që ekziston:

“... Dëshmi e qartë se aftësitë njohëse, gjuhësore dhe akademike gjithashtu mund të jenë të forcuara nga përvoja e ECEC dhe këto ka të ngjarë të luajnë një rol edhe më vonë sukseset arsimore, sociale dhe ekonomike që shpesh gjenden të implementuara mirë në ndërhyrjet e ECEC” (Melhuish et al., 2015: 24).

Pinter (2006) sugjeron disa përfitime nga mësimi i hershëm i gjuhës së huaj, të tilla si zhvillimi i aftësive themelore të komunikimit të fëmijëve në anglisht dhe shqiptimi në vend si anglisht, inkurajimi i kënaqësisë, motivimi, të mësuarit për kulturat e tjera, 'të mësuarit për të mësuar', si dhe si zhvillim i aftësive njohëse të fëmijëve dhe vetëdijës metalinguistike. Për Rosembuch

(1995), një nga përfitimet e treguara nga hulumtimi është zhvillimi i qëndrimeve pozitive ndaj diversitetit.

Në botimin më të fundit mbi mësimin e gjuhës së huaj parashkollore, Murphy dhe Evangelou (2016) theksojnë se "nuk ka rishikim të kryer në kontekstin e mësuar të gjuhës së huaj që tregon pa mëdyshje avantazhe për të rinjtë se nxënësit më të vjetër" dhe të konkludojmë se "është vërtet interesante të theksohet një numër i shtuar i vendeve që prezantojnë anglishten si pjesë e parashikimit parashkollor.

Sa i perket mësimdhënies së gjuhës angleze në Kosovë, gjuha angleze është lëndë obligative që nga klasa e parë me vendim të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës-MASHT, duke ofruar kështu anglishten edhe në nivelin parashkollor në disa shkolla, por jo në tërë rajonin e Kosovës. Një mbështetje mjaft e madhe në gjithë këtë proces është edhe KETNET(Kosovo English Teacher's Network) e cila është një organizatë profesionale, jofitimprurëse dhe jo-politike qëllimet e së cilës janë promovimi i bursave, shpërndarja e informacionit, forcimi i udhëzimeve dhe kërkimeve në të gjitha nivelet në mësimin e gjuhës angleze dhe bashkëpunimi në mënyra të përshtatshme me grupe të tjera që kanë interes të ngjashëm,pra si një shoqatë profesionale e mësuesve të gjuhës angleze në të gjithë Kosovën, KETNET synon të marrë pjesë në vendosjen, promovimin dhe mirëmbajtjen e standardeve të larta në mësimin dhe mësimin e gjuhës angleze, dhe të mbështesë zhvillimin profesional dhe krijimin e rrjeteve për mësuesit e gjuhës angleze. Fillimisht i organizuar në shkallë kombëtare, KETNET aspiron të përfshijë brenda kornizës së saj degë në secilën nga shtatë Qendrat Rajonale të Kosovës: Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë dhe Prizren që organizon trajnime për avancimin e mësimdhënësve me metoda efektive për grupmosha të ndryshme. Pra, si i tillë, KETNET ka për qëllim të ndihmojë mësueset që ndjekin trajnime përmes këtij rrjeti të ngriten në mënyrë akademike dhe profesionale duke përmendur disa nga këto objektiva si: të marrë rolin udhëheqës në ofrimin e mundësive të trajnimit gjatë shërbimit;

Të shpërndajë informacion në lidhje me mësimin e gjuhës dhe mundësitë dhe lehtësitë brenda dhe jashtë vendit për zhvillim profesional;

Të përmirësojë praktikën e mësimdhënies dhe mësimin të gjuhës;

Të promovojë standarde të larta të trajnimit të mësuesve në gjuhë para-shërbimi dhe në shërbim;

Të nxisë dhe promovojë bursa në lidhje me mësimin e gjuhës;

Të nxisë standarde të larta akademike dhe profesionale në mësimin dhe mësimin e gjuhës;

Të inkurajojë bashkëpunimin dhe mbështetjen e ndërsjellë, të mësuarit në bashkëpunim dhe të mësuarit në komunitete; dhe Të sigurojë krijimin e rrjeteve dhe mundësi të tjera për zhvillimin e gjuhës angleze

1.2 Roli i mësuesit në mësimdhënien e Gjuhës Angleze

Roli i mësuesve individualë duket të jetë thelbësor për suksesin në punën me fëmijët anglezë, veçanërisht besueshmërinë dhe gatishmërinë e mësuesve për të përdorur gjuhën në mënyrë sa më natyrale në klasë dhe kështu sigurojnë ekspozimin e nevojshëm të gjuhës (Pinter, 2006).

Mësuesit e arsimit parashkollor duhet të mbajnë në mend se fëmijët së pari zhvillojnë të kuptuarit e gjuhës, pastaj fillojnë të përgjigjen në gjuhën amtare, dhe pastaj flasin gjuhën e dytë pak nga pak, kur ndjehen të qetë dhe janë të gatshëm të flasin fjali më të gjata. Gjithashtu nëse flasin gjuhën e tyre amtare shpesh, fëmijët mund të hutohen dhe nuk do të bëjnë përpjekje për të përdorur anglisht pasi ata e dinë se mësuesi i kupton ato gjithsesi dhe do të përfundojnë duke thënë atë më vonë në gjuhën e tyre amtare.

Për të motivuar fëmijët drejt gjuhës angleze, rekomandohet të lavdërohen për përpjekjen dhe përmirësimin e bërë kur ata fillojnë të përdorin gjuhën me dëshirë, edhe nëse nuk e përdorin atë saktë ose e përziejnë me gjuhë tjera.

Përdorimi i qasjes për të mësuar bashkëpunim (Collaborative Learning -CL) për arsimin do të thotë të organizosh klasën në disa grupe që punojnë së bashku dhe të ndajnë përvojat akademike dhe sociale, duke inkurajuar detyra krijuese, intelektuale dhe të hapura. Në qasjen CL, mësuesit shkëmbejnë rolin e tyre, nga dhënia e informacionit deri tek lehtësimi i mësimin të nxënësve të tyre. Grupi arrin sukses kur të gjithë punojnë në mënyrë bashkëpunuese, ndërsa fitojnë vetëvlerësim, aftësi shoqërore, vendosin një lidhje më të fortë me shokët e klasës dhe performojnë më mirë sesa kur mësojnë individualisht (Ross & Smyth, 1995).

1.3 Llojet e metodologjive të gjuhës angleze te fëmijët parashkollor

Disa nga metodologjitë efektive të cilat përdoren për mësimnxënien e Gjuhës Angleze te fëmijët parashkollor janë:

1.3.1 **The Silent Way method**, mësuesi përpiket të thotë fjalët më të pakta të mundshme për t'i ndihmuar fëmijët të ndjehen rehat dhe të gjejnë fjalët e duhura për t'i ndihmuar ata të

- shprehen. Edhe nëse një fëmijë thotë "Unë shkoj tualet", fëmija do të ishte në kontroll të asaj që ata po përpiqen të thonë pa përdorur gjuhën e tyre amtare,
- 1.3.2 **The Community Language Learning** përpiqet të krijojë lidhje të forta personale midis mësuesit dhe fëmijëve pa ndonjë kufi mësimi, duke përdorur gjuhën amtare, duke e përkthyer atë në anglisht dhe duke inkurajuar përsëritjen dhe familjarizimin me konceptet e reja (Krashen, 1982),
- 1.3.3 **The Direct Method** përdoret plotësisht në anglisht, dhe fëmijët inkurajohen të përgjigjen edhe në anglisht, duke mos përdorur gjuhën amtare, përveç nëse është jashtëzakonisht e nevojshme. U vëzhgua drejtpërdrejt në "Colegio San Patricio" se deri në fund të periudhës parashkollore fëmijët mund t'i drejtohen në mënyrë të përsosur mësuesve të tyre në anglisht dhe t'i kuptojnë ata duke përdorur një metodë të drejtpërdrejtë, duke përmirësuar blerjen në anglisht të studentëve të tyre,
- 1.3.4 **Metoda "The Audio-lingual"** bazohet në të mësuarit e anglishtes me anë të përshtatjes së zakoneve në klasë. Promovimi i dialogut në secilën situatë. Për shembull, në rutinat e mëngjesit, të tilla si këndimi, lutja, bërja e kalendarit, moti, përcaktimi i rregullave të klasës, etj. Kjo metodë mbështet idenë që për të mësuar një gjuhë, së pari duhet të dëgjohet dhe kuptohet para se ta shihni në formën e saj të shkruar,
- 1.3.5 **Metoda "Suggestopedia"** konsiston në transmetimin se gjuha angleze është e lehtë, duke shmangur ose hequr blloqet mendore drejt mësimit në anglisht, e cila konsiston në procedura të tilla si këndimi ose kryerja e aktiviteteve të thjeshta,
- 1.3.6 **The Communicative language teaching method (CLT)** zhvillon situata për të komunikuar në mënyrë efektive në situata të ndryshme, të tilla si në shkollë, pazar, në rrugë, ose te mjekët, duke sugjeruar nocione, fakte ose vendndodhje, dhe duke i ftuar fëmijët e tjerë të marrin pjesë në rritjen e besimit të tyre me të folur anglisht në mjedis të ndryshme,
- 1.3.7 **Metoda "The Immersion"** nënkupton të mësuarit e lëndëve shkollore në një mjedis anglez, dhe të mësojnë anglisht ndërsa mësojnë gjuhën e tyre amtare, si një mjet për të "mbijetuar". Kjo metodë mund të ndjekë Qasjen Natyrore të propozuar nga Krashen (1982) që nënvizon ngjashmëritë e mësimit të gjuhës amtare dhe gjuhës së dytë. Nuk do të ketë korrigjime, pasi ato do të formësoheshin natyrshëm,

1.3.8 **The Correction Methods** Rëndësia e gabimeve në procesin e të mësuarit mund të shoqërohet me mësuesit që nuk shqetësohen për shkallën e të nxënit të fëmijës, çfarë i bën ata të mësojnë, cilat metodologji për të përdorur, si t'i përshtatin ato me karakteristikat e secilit grup dhe u mungojnë pritjet të njohurive që duhet të fitohen. Për më tepër, disa mësues nuk u japin rëndësi disa gabimeve të fëmijëve, duke i konsideruar ato të parëndësishme. Normalisht, mësuesit duhet së pari të përpiqen të ndihmojnë fëmijët si gjuhë dhe të ndjehen të qetë ta flasin atë. Pastaj, pasi të jenë të sigurt mund të përdoren disa metoda korrigjimi për të korrigjuar gabimet në anglisht duke mos ndikuar në besimin e tyre të cilat janë:

- **Eko Method:** Kjo metodë u propozua nga Z. Stevens, një mësues. Përdoret ndërsa keni një bisedë një-për-një me një fëmijë që përsërit gabimin por në mënyrë korrekte. Për shembull, nëse një fëmijë thotë: "Dje shkoj në park" dhe mësuesi do të tregonte interes dhe do të thoshte "Me të vërtetë? Çfarë keni bërë?" Mësuesi do të theksonte fjalën "shkoi" duke e shqiptuar atë me zë të lartë dhe më të ngadaltë dhe të buzëqeshur, kështu që fëmija e shoqëron atë dhe e kupton vetë gabimin, dhe përpiket ta kujtojë për herën e ardhshme (Z. Stevens. Komunikimi personal, Prill 2016). Gjatë zhvillimit të projektit, kjo metodë është përdorur me fëmijë pesëvjeçarë, për të cilët disa do të përsërisnin "Po unë shkova në park", duke demonstruar se ata me të vërtetë kishin marrë reagimet dhe e kishin korrigjuar, pa qenë e nevojshme të ndërpresin bisedën. Për më tepër, u tregua gjithashtu se disa fëmijë të tjerë që po dëgjonin morën përshtypjet dhe më vonë thanë "edhe unë shkova në park" dhe metoda

Method Peer-to-Peer, ku disa fëmijë kanë një zhvillim më të lartë në anglisht se të tjerët, disa flasin anglisht në shtëpi, kështu që është e rëndësishme që të gjithë fëmijët të jenë të hapur ndaj çdo korrigjimi dhe sugjerimi nga kolegët e tyre dhe inkurajohen të ndajnë aftësitë dhe të kuptuarit e tyre në anglisht. Nëse do të duhej t'i thonin diçka mësuesit, ata mund të punojnë së bashku si ta bëjnë atë.

Metodë gjithashtu shumë efektive për mësimin e gjuhës angleze të fëmijët parashkollor është edhe metoda e bashkëpunimit, metodë të cilën e përkrahin edhe shumë studiues të ndryshëm.

Me zbatimin e mësimin bashkëpunues në mësimin e gjuhës së huaj, fëmijëve u ofrohen më shumë mundësi për të marrë pjesë, fitojnë më shumë përvojë për të bashkëpunuar

dhe bashkëpunuar në mësimin e gjuhës së huaj. Në grupin bashkëpunues, fëmijët punojnë së bashku, duke bashkëvepruar ballë për ballë, me qëllimin identik të mësimin, si dhe ndihmojnë njëri-tjetrin (Borich, 2007).

1.3.9. Çka është metoda TPR?

Përgjigja totale fizike (TPR) është një metodë e mësimin të një gjuhe të huaj ose të dytë (gjuhë e synuar) duke zhvilluar të kuptuarit e të dëgjuarit përmes një serie komandash të cilave fëmijët përgjigjen me aktivitetin fizik. Ajo u themelua nga James Asher, një profesor i psikologjisë, në fund të viteve 1960 dhe ende konsiderohet dhe përdoret si një mjet i vlefshëm gjuhësor në mësimin e një gjuhe të synuar, veçanërisht në fazat fillestare të mësimin. Ai kombinon gjuhën dhe gjestin, duke e bërë kështu përvetësimin e gjuhës më të natyrshëm dhe të paharrueshëm (Asher 2007; Curtain and Dahlberg 2010; Larsen-Freeman 2004; Morley 2001). Nxënësit nuk pritët të flasin gjatë kryerjes së veprimeve, gjë që e bën TPR pa stres dhe të përshtatshme për fillestarët e mësimin, as për nxënësit të rinj, adoleshentët apo të rritur (Asher 2007).

Fëmijëria e hershme është një periudhë e çmuar kur fëmijët marrin performancën e tyre më të shpejtë në drejtim të zhvillimit emocional, fizik, njohës dhe gjuhësor (Crain, 2005).

Mësuesi është modeli dhe drejtori. Mësuesi/ja ofron mundësi për të mësuar. Kur TPR të përfshihet në rutinat, nxënësit menjëherë do të përfshihen në gjuhë dhe do të angazhohen të reagojnë ndaj tij. Ata së shpejti do të kuptojnë se ata kuptojnë shumë gjëra dhe do të ndërtojnë besim ndërsa mësojnë (Richards & Rodgers, 2001). Mësuesi merr rolin e prindit; duke i dhënë udhëzime, duke vendosur modele, duke luajtur lojëra, dhe studenti më pas i përgjigjet fizikisht shpejtë. Në dhënien e mendimeve, mësuesi përgjigjet pozitivisht në përgjigjen e saktë, në mënyrën sesi do të dëshironte një prind. Kjo forcon të mësuarit dhe inkurajon hapa të mëtejshëm. Edhe pse TPR është një teknikë e fuqishme, është më efektive kur përcillet me lojëra, këngë, histori ose demonstrime.

Sipas Scott dhe Ytreberg (1990), mirëkuptimi i fëmijëve vjen përmes duarve dhe syve dhe veshëve dhe bota e tyre fizike është mbizotëruese në çdo kohë.

Ndoshta, metoda më efektive është metoda e përgjigjes fizike totale (TPR) sepse dikush kujton: 10% të asaj që ka lexuar, 20% të asaj që ka dëgjuar, 30% të asaj që ka parë, 50% të asaj që ka dëgjuar dhe parë, 70% e asaj që ka thënë një, 90% e asaj që ka bërë.

Duke e parë rëndësinë e mësimi të gjuhës së huaj, respektivisht të gjuhës angleze në botë, por edhe në Kosovë, ky punim ka për qëllim të analizojë metodat që aplikohen në mësimdhënien e gjuhës angleze tek fëmijët e moshës parashkollore.

1.4 Rëndësia e lojrave te fëmijët

Nxënësit u ekspozohen lojërave gjatë ditëve në shtëpitë e tyre, në kompjuterët e tyre, në internet dhe madje edhe në celularët e tyre. Edhe pse disa mësues kanë vendosur të përdorin lojërat si pjesë të qasjes mësimore ose demonstrimit, shumica e tyre nuk do të kishin të njëjtën ide rreth lojërave dhe veçanërisht, ata mësues që kanë përfshirë lojëra si teknikë e tyre mësimore mund të mos i përdorin ato në potencialin e tyre (Marzano, 2010). Sipas Harfield (1999), një lojë është një veprimtari me rregulla, një qëllim dhe një element argëtimi. Ai deklaroi se “Lojërat duhet të konsiderohen si pjesë përbërëse e planprogramit gjuhësor, jo si një veprimtari zbavitëse për pasditen e së Premtes ose për mbarimin e afatit dhe mund të përdoren në të gjitha fazat e përparimit nga praktika e kontrolluar në të lirë, duke shërbyer në njërin skaj të rangut si ndihmë memorie dhe stërvitje/përsëritje, në anën tjetër si një shans për të përdorur gjuhën lirshëm dhe si një mjet për një qëllim sesa një qëllim në vetvete. Lojërat mund të shërbejnë si një mjet diagnostikues për mësuesit, të cilët mund të shënojnë fusha të vështirësisë dhe të ndërmarrin veprime të duhura përmirësuese.

Shumë studime kanë matur suksesin e të mësuarit bashkëpunues si një metodë mësimore dhe propozuan disa metodologji siç janë: grupe problemesh, laboratorë dhe projekte, bashkim pjesësh figure, redaktim kolegësh dhe mësimdhënie të ekipit të udhëhequr nga bashkëmoshatarët (Felder & Brent, 2007). Mësimi i lëndës së gjuhës angleze po përhapet në të gjithë botën, jo vetëm si një lëndë e gjuhës së huaj por gjithnjë e më shumë si një gjuhë e të mësuarit në teresi. Mësimi i Gjuhës Angleze i zbaton mësimet angleze në të gjithë kurrikulat (Kirkpatrick 2011).

1.5 Faktorët e fëmijëve për të mësuar një gjuhë të dytë

Faktorët e fëmijëve për të mësuar një gjuhë të dytë janë:

Në përgjithësi, ka faktorë që ndikojnë në çdo mësim të gjuhës qoftë së pari gjuhë e huaj apo gjuhë e dytë, këta përfshijnë faktorët e nxënësit dhe procesin e nxënësit (Alcon dhe Guzman, 2000). E këta janë: Moshë, motivimi, ankthi, ekstroversioni, aftësia, stili njohës dhe teknikat e të mësuarit individual. Nga ana tjetër, procesi i nxënësit mund të shpjegohet në dy këndvështrime që është gramatizimi gjuhësor dhe aftësia njohëse në atë që duhet të bëjë nxënësi për të zhvilluar gjuhën e tyre të dytë (Kumaravadivelu, 1994).

1.6 Avantazhet e mësimin të hershëm të gjuhës

Fëmijët që fillojnë të studiojnë dhe zotërojnë një gjuhë të huaj, arrijnë besim më të madh, fitojnë aftësinë për të komunikuar me njerëzit jashtë grupit të tyre të ngushtë gjuhësor dhe zhvillojnë vetëbesim me kalimin e kohës duke u inkurajuar të flasin një gjuhë të huaj me më pak ankth. Fëmijët dhe të rriturit kështu do të kenë më pak frikë nga procesi dhe do të gëzojnë aftësinë për të komunikuar me njerëzit në gjuhën e tyre amtare. Shumë ekspertë arsimorë sugjerojnë që të rriturit dhe fëmijët të mësojnë gjuhën e tyre të zgjedhur përmes dëgjimit të këngëve dhe të folurit ritmik për të ndërtuar besim në aftësitë e tyre. Kur fëmijët e vegjël mësojnë një gjuhë të huaj ata zhvillojnë një theks natyror, të ngjashëm me origjinë. Për fëmijët dhe të rriturit, të mësuarit e një gjuhe të huaj mund të çojë në mundësi më të mira si në kolegji ashtu edhe në karrierën e tyre. Mësimi i një gjuhe si pjesë e një veprimtarie familjare gjithashtu mund të krijojë marrëdhënie. Lidhjet kulturore janë shumë më të lehta për fëmijët dhe të rriturit që studiojnë një gjuhë të huaj dhe mund të çojnë në miqësi të dobishme dhe shoqata biznesi. Fëmijët që mësojnë një gjuhë të huaj gjithashtu kanë rezultate vazhdimisht më të larta në aktivitete dhe teste të ndryshme në krahasim me shokët e tyre që nuk mësojnë asnjë gjuhë të huaj.

1.7 Rëndësia e motivimit gjatë mësimin të gjuhës angleze

Kur fëmijët ose të rriturit fillojnë të mësojnë një gjuhë të huaj, aftësitë njohëse zhvillohen, veçanërisht tek fëmijët. Kjo lidhet disi me mendimin e shprehur nga Dunn (2011) i cili besonte se fëmijët e vegjël, në krahasim me llojet e tjera të nxënësve, janë ata që priren të humbasin

interesin dhe demotivohen më shpejt për aktivitetet të cilat i konsiderojnë shumë të vështira ose të mërzitshme për ato.

Këtë mund ta kuptojmë edhe përmes një hulumtimi të bërë nga Barzso (2008) i cili hulumtoi se si një folës jo-autokton mund të prezantojë anglisht tek fëmijët e kopshteve, duke nxitur motivimin dhe efikasitetin për mesimin e kësaj gjuhe. Për këtë, ai punoi me 22 fëmijë të moshës 3-6 vjeç, me të cilët pati 11 takime. Në këto takime, aktivitetet për mesimin e gjuhës angleze ndryshonin nga 15 në 60 minuta. Ai prezantoi një sërë aktivitetesh (p.sh. duke kënduar vjersha të çerdheve, duke luajtur lojëra, lexim të përbashkët nga një libër me figura, etj.) ku tentoi të zbulonte nivelin e motivimit. Si përfundim, ai zbuloi se niveli i motivimit për mesim të gjes se huaj varej nga mënyra sesi ai i motivonte fëmijët të mësojnë gjuhën. Nëse aktivitetet e lidhura me Anglinë nuk ishin interesante e lëre më të mërzitshme, fëmijët nuk donin t'i ndiqnin ato dhe shkonin të luanin lojëra të tjera në gjuhën e tyre amtare. Fëmijët nuk mund të merren me aktivitete që zgjasin përtej periudhës së caktuar kohore kështu që ndryshimi i aktiviteteve ishte shumë i rëndësishëm. Ai (Borzo, 2008) gjithashtu zbuloi se gjatësia totale e kohës që kaloi në kopshtin e fëmijëve nuk do të ishte e mjaftueshme për formim të fëmijëve për të komunikuar në anglisht.

Nga tërë kjo se çka u cek më lartë lidhur me metodat që aplikohen për mësim, me fokus të veçantë në mesimin e gjuhës angleze, është me rëndësi të hulumtohet edhe mendimi i mësimdhënësve të gjuhës angleze që u japin mësim fëmijëve të moshave parashkollore. Duke jetuar në shekullin XXI, natyrisht se ka evolime në mësimdhënie, që do të thotë ka ndryshime edhe në metodat e mësimdhënies, teknikat dhe aktivitetet e ndryshme në të gjitha lëndët, duke përfshirë edhe mesimin e gjuhës së huaj. Por është me interes të veçantë të vërehet nëse mësimdhënësit janë të interesuar të avancohen duke ndjekur trajnime për të mësuar metoda të reja që do të aplikojnë në mësimdhënien e tyre, e në rastin tonë në avancimin e mësimdhënësve të gjuhës angleze për fëmijët e nivelit parashkollorë për të aplikuar metoda të përshatshme për moshën e tyre, sic ishte edhe KETNET-i.

2. METODOLOGJIA

2.1. Dizajni i hulumtimit

Ky hulumtim është kuantitativ (sasior).

Qëllimi i këtij punimi është qasja më e mirë dhe metodologjitë më të përshtatshme për mësimin e gjuhës angleze si gjuhë e dytë në arsimin parashkollor të fëmijët e moshës 5-6 vjeçar. Si i tillë, ky punim parashtron keto hipoteza:

H1 - Metoda e bashkpunimit është më efektive se ajo individuale

H2 - Mësueset të cilat jetojnë në qytete shprehin interesim më të madh për të marrë pjesë në trajnime të ndryshme që kanë të bëjnë me metodat efektive të mesimdhënis

2.2 Pjesëmarrësit

Popullata e këtij punimi janë mësueset e institucioneve private, më konkretisht mësueset e gjuhës angleze që punojnë me fëmijët të cilët ndjekin kurse private në fëmijërinë e hershme të moshave 5-6 vjeçare.

Numri total i pjesëmarrësve ishte gjithsej 11 mësuese.

2.3 Instrumentet

Instrumenti matës (pyetësori) është marrë nga (Maria G. Catalano., Perucini P., & Vecchio M. Gjovani., 2015) të Universitetit Degli Studi Roma Tre dhe është bërë adaptimi i tyre në baze të interesit të punimit.

Pyetsori ka gjithsej 24 pyetje prej të cilave 7 janë pyetje demografike. Këtij pyetsori i janë përgjigjur vetëm mësueset.

2.4 Mënyra e mbledhjes së të dhënave

Pasiqë pyetësi është shpërndarë tek mësueset, po i njëjti u mblodh nga 11 mësuese (teachers) të rrethit të Vushtrrisë.

2.5 Analizat

Të dhënat e këtij punimi janë analizuar me Pakon Statistikore të Shkencave Sociale (SPSS) version 20 dhe janë përdorur analiza përshkruese, T- testi dhe analiza e Anovës.

2.6 Aspekti etik

Të dhënat të cilat janë mbledhur kanë qenë krejtësisht konfidenciale dhe anonime. Ato të dhëna janë përdorur vetëm për qëllimin e këtij punimi dhe nuk janë keqpërdorur për asnjë qëllim tjetër. Procesi i plotësimit të pyetësorit u realizua nga mësueset dhe pjesëmarrja në plotësim ka qenë e vullnetshme dhe asnjë pjesëmarrësi nuk i është imponuar plotësimi i tij.

3. REZULTATET

Analiza deskriptive u përdor për të përshkruar të dhënat demografike të pjesëmarrësve që morrën pjesë në këtë punim.

Numri i pjesëmarrësve në total ishte 11, prej të cilëve të gjitha ishin femra. Pjesëmarrësit të moshës 20-30 vjec ishin 23% (N=3), 8% (N=1) ishin të moshës 30-40 vjec, 31% (N=4) ishin të moshës 40-50 vjec dhe 23% (N=3) ishin të moshës mbi 50 vjec.

Kurse sa i përket vendbanimit 18% (N=2) jetonin në fshat dhe 82% (N=9) jetonin në qytet.

Tabela 1


Numri dhe Përqindja e Pjesëmarrësve Sipas Moshes, Gjinisë dhe Vendbanimit

	N	%
Gjnia		
Femër	11	100
Mashkull	0	0
Mosha		
20-30 vjec	3	23
30-40 vjec	1	8
40-50 vjec	4	31
Mbi 50 vjec	3	23
Vendbanimi		
Fshat	2	18
Qytet	9	82

Punimi ka përfshirë mësuese të pesë shkollave, prej të cilave 36% (N=4) kanë qenë të shkollës “Mustafë Venhari”, 18% (N=2) të shkollës “Naim Frashëri”, 18% (N=2) të shkollës “Ali Kelmendi”, 18% (N=2) të shkollës “Anton Zako Cajupi” dhe 10% (N=1) e Institucionit Parashkollor “Foleja”, të cilat gjithashtu secila mbajnë edhe kurse private për fëmijët

parashkollor. Të gjithë fëmijët në këto shkolla e mësojnë gjuhën angleze si gjuhë të huaj duke përfshirë këtu edhe fëmijët e Edukimit Parashkollor.

Gjithashtu sa i përket nivelit të shkollimit 91% (N=10) ishin BA (Bachelor) dhe 9% (N=1) MA (Master).




Grafiku 1. Shpërndarja e numrave dhe përqindjeve sipas gjinisë, moshës dhe vendbanimit

Tabela 2

Numri dhe Përqindja e Pjesëmarrësve Sipas Shkollës në të Cilën Punojnë dhe Sipas Shkollimit

	N	%
Emri i shkollës		
Mustaf Venhari	4	36
Naim Frashëri	2	18
Ali Kelmendi	2	18
Anton Zako Cajupi	2	18
IP Foleja	1	9
Shkollimi		
I mesëm	0	0
BA	10	91
MA	1	9
Doktoraturë	0	0



Grafiku 2. Shpërndarja e numrave dhe përqindjeve sipas emrit të shkollës dhe nivelit të shkollimit

Anova njëdrejtimëshe midis Metodës së Bashkëpunimit dhe Metodës Individuale

Rezultatet e pyetsorit treguan se Metoda e Bashkëpunimit është më efektive se Metoda Individuale.

100 % (N=11) të respondentëve u pajtuan me deklaratën se Metoda e Bashkëpunimit është më efektive dhe më e përshtatshme sesa Metoda Individuale. Sipas të dhënave shohim se metoda e bashkëpunimit vlerësohet në masë të madhe nga mësuesit e gjuhës angleze dhe kësajsoji shihet si e domosdoshme dhe pjesë e pandashme e procesit mësimor.

Andaj me zbatimin e metodës bashkëpunuese në mësimin e gjuhës së huaj, fëmijëve u ofrohen më shumë mundësi për të marrë pjesë në aktivitete dhe fitojnë më shumë përvojë për të bashkëpunuar në mësimin e gjuhës së huaj.

Tabela 3 – t - Testi

Mesi Aritmetik dhe Devijimi Standard sipas Vendbanimit dhe Variablës së Pjesëmarrjes në Trajnime të Ndryshme në Gjuhën Angleze

	N	M	SD	T	Df	P
Vendbanimi						
Fshat	2	3.50	2.121	-.224	8	.829
Qytet	9	3.75	1.282			

Analiza e T-testit tregon se nuk ka dallime signifikante mes Vendbanimit $t(11) = -.224$, $p = .829$ dhe pjesëmarrjes në trajnime të ndryshme në Gjuhën Angleze.

Kur i krahasuam si konstrakte të vetme Vendbanimit nuk tregoi dallime signifikante me pjesëmarrjen në trajnime të ndryshme në Gjuhën Angleze. Nga të dhënat shohim se në

pjesëmarrjen në trajnime të ndryshme në gjuhën angleze nuk ka rëndësi dhe nuk tregon ndonjë rol vendbanimi i respondentëve.

Tabela 4

Mesi Aritmetik dhe Devijimi Standard midis Vendbanimit dhe Lloj-llojshmërisë së Metodave Brenda një Aktiviteti

Vendbanimi	N	M	SD	T	Df	P
Fshat	2	1.50	.707	-.251	9	.808
Qytet	9	1.67	.866			

Analiza e T-testit tregon se nuk ka dallime signifikante mes vendbanimit $t(11) = -.251$, $p = .808$ dhe Lloj-llojshmërisë së metodave brenda një aktiviteti. Kur i krahasuam si grupe mes vete Vendbanimi nuk tregoi dallime signifikante me Lloj-llojshmërinë e metodave brenda një aktiviteti. Të dhënat tregojnë se nuk ka rëndësi vendbanimi ku jetojnë respondentët me lloj-llojshmërinë e metodave që ata përdorin brenda një aktiviteti.

Tabela 5

Mesi Aritmetik dhe Devijimi Standard midis Moshes dhe Pjesëmarrjes në Trajnime të Ndryshme në Gjuhën Angleze

	Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	5.350	3	1.783	.995	.456
Within Groups	10.750	6	1.792		
Total	16.100	9			

Dallimet mes grupeve në kuadër të moshës me ndjekjen e trajnimeve të ndryshme në Gjuhën Angleze nuk treguan rëndësi statistikore. Kur i krahasuam si konstrukte të vetme Moshë e respondentëve nuk tregoi dallime signifikante me ndjekjen e trajnimeve të ndryshme në Gjuhën Angleze. Të dhënat tregojnë se moshë e respondentëve nuk ndikon në ndjekjen e trajnimeve të ndryshme në gjuhën angleze. Me pjesëmarrjen në trajnime të ndryshme në gjuhën angleze atëherë bëhet edhe shpërndarja e informacioneve për mësimin sa më të lehtë të gjuhës dhe të nxisin standarde më të larta akademike dhe profesionale në mësimin e gjuhës angleze.

Tabela 6

Mesi Aritmetik dhe Devijimi Standard midis Përvojës së Punës dhe Metodës së Bashkëpunimit

	Sum of Squares	Df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	3.545	7	.506	1.519	.397
Within Groups	1.000	3	.333		
Total	4.545	10			

Kur i krahasuam mes veti veqmas variablat e Përvojës së Punës dhe Metodës së Bashkëpunimit pamë se nuk ekzistojnë dallime të rëndësishme statistikore.

Nga ajo që shohim në tabelën 5 shohim që vlera e p-së (Sig) .397 është më e madhe se 0.005 dhe arrijmë në përfundim se nuk ka dallime signifikante mes variablave. Të dhënat tregojnë se përvoja e punës nuk ndikon në aplikimin e metodave të bashkëpunimit gjatë orëve të gjuhës angleze me fëmijë parashkollorë. Duke ditur se metoda e bashkëpunimit bënë që edhe fëmijët të socializohen mes vete atëherë kjo metodë është më e aplikueshme nga të gjithë respondentët pa marrë parasysh sa vite përvojë në punë kanë.

4. DISKUTIME

Pas shqyrtimit të literatures dhe rezultateve të dhëna nga ky punim mund të diskutojmë rreth gjetjeve tona, duke i vërtetuar ose hedhur poshtë hipotezat.

Hipoteza 1. Metoda bashkëpunuese është më efektive sesa ajo individuale. Gjetjet e këtij hulumtimi e vërtetojnë hipotezën e parë. Me analizën e Anovës njëdrejtimëshe vërtetuam se Metoda e Bashkëpunimit është më efektive se Metoda Individuale, dhe në rastin tonë hulumtuam si metoda bashkëpunimi mund të mirren edhe silent the way....

Nga analiza e anovës njëdrejtimëshe, 11 pjesëmarrës që kanë marrë pjesë në hulumtim ose thënë në shifra 100% prej tyre janë pajtuar me deklaratën se Metoda e Bashkëpunimit është më efektive dhe më e përshtatshme sesa Metoda Individuale, gjithashtu është më e preferuara në mesin e mësimitdhënësve të gjuhës angleze tek fëmijët e moshës parashkollore. Kjo përkon edhe me studiues të ndryshëm të cilët thonë se mësimi bashkëpunues është një proces që rrit nivelin e të mësuarit dhe të kënaqësisë, i cili është rezultat i punës në ekipin me performancë të lartë (Felder dhe Brent, 2012).

Për Wichadee dhe Orawiwatnakul (2012), mësimi bashkëpunues është një strategji mësimore me fëmijë të niveleve të ndryshme të aftësive në grupe të vogla që përdorin veprimtari të ndryshme mësimore për të përmirësuar të kuptuarit e tyre për një lëndë.

Pra nga mendimi i studiuesve dhe të dhënat e fituara nga pjesëmarrësit e këtij punimi, vërtetojmë se Metoda Bashkëpunuese është gjithnjë më efektive sesa ajo Individuale.

Hipoteza 2. Mësueset të cilat jetojnë në qytete shprehin interesim më të madh për të marrë pjesë në trajnime të ndryshme. Gjetjet e këtij hulumtimi e vërtetojnë edhe hipotezën e dytë. Bazuar në analizën e t – Testit 82% e pjesëmarrësve që jetojnë në qytet kanë interesim më të madh për të marrë pjesë në trajnime të ndryshme, ndërsa 18% prej tyre jetojnë në fshat dhe kanë interesimin shumë të vogël për të marrur pjesë në trajnime të ndryshme.

Trajnimet e ndjekura bëjnë që edhe mësueset të kenë njohuri më të larta sa i përket metodologjive të cilat përdoren për të mësuar fëmijët një gjuhë të dytë në mënyrë sa më të lehtë dhe të kapshme, mësojnë më shumë edhe rreth sistemit metodologjik i cili përdoret edhe në vende të ndryshme të botës.

5. KONKLUDIME DHE REKOMANDIME

Ky hulumtim kishte për qëllim të zbulonte metodat efektive të mësimnxënies së gjuhës angleze te fëmijët parafillor të moshave 5-6 vjeq në komunën e Vushtrrisë. Të gjitha rezultatet u mblodhën nga mësueset e Gjuhës Angleze të cilat njëkohësisht mbajnë edhe kurse private me fëmijët parashkollorë.

Gjetjet e këtij hulumtimi treguan se ekzistojnë shumë metoda efektive me të cilat fëmijët mund të mësojnë gjuhën angleze në Institucione Parashkollore, në shkolla dhe në kurse private. Pra, këta faktorë siç janë: moshë, motivimi, ankthi, ekstroversioni, aftësia, stili njohës dhe teknikat e të mësuarit individual duhet të merren parasysh gjatë zgjedhjes së metodologjive të cilat përdoren nga mësueset sepse në moshën parashkollorë fëmijët arrijnë potencialin maksimal i cili gjithsesi se vërehet në periudha më të vonshme.

U vërtetua se Metoda e Bashkëpunimit është më efektive dhe më e përshtatshme sesa Metoda Individuale, por është më e preferuara në mesin e mësimitdhënësve të gjuhës angleze tek fëmijët e moshës parashkollorë.

Gjetjet e këtij hulumtimi vërtetuan se pjesëmarrësit që jetojnë në qytet kanë interesim më të madh për të marrë pjesë në trajnime të ndryshme, ndërsa pjesëmarrësit që jetojnë në fshat kanë interesimin shumë më të vogël për të marrur pjesë në trajnime të ndryshme.

Gjithashtu ne mund të themi se në këtë kapitull ka hulumtime që tregojnë se mësimi i gjuhës angleze përmes ECEC është kryesisht në fillimet e tij (Melhuish e të tjerë, 2015). Përkundër këtij diversiteti, ekzistojnë një numër temash të zakonshme që dalin, duke nënvizuar rëndësinë e tyre. Këto lidhen me edukimin e mësuesve dhe me faktin se sa e rëndësishme është që ne të zhvillojmë udhëzime dhe trajnime të përshtatshme për mësuesit e fëmijëve të vegjël që mësojnë anglisht.

Edukimi Parashkollor është përmendur si "nota më e rëndësishme" (Barnett dhe Husted, 2003) për shkak të përfitimeve të shumta afatgjata që shoqërohen me fëmijët që ndjekin provizionin parashkollor me cilësi të mirë.

Mund të konkludojmë se metoda e bashkëpunimit në rastin e nivelit të mësimdhënies së gjuhës angleze në nivelin parashkollor, metoda e bashkëpunimit është një term "ombrelle" e metodave të lloj-llojshme të cilat përdoren për mësimin e gjuhës angleze të fëmijëve parashkollor siq janë

“In the Silent Way”, “ The direct Method”, “ Metoda TPR” e shumë metoda tjera të njohura, ku shtjellojnë avantazhet të cilat i fiton fëmija gjatë këtij procesi (M. Gjovani, 2015)

Gjithashtu nga këndvështrimi i hulumtimit, ekziston një mungesë e praktikave efektive të mësimit të Gjuhës Angleze, megjithatë ne jemi shpresëdhënës që me kalimin e kohës kjo do të ndryshojë, pasi gjithnjë e më shumë studiuesit janë duke i kushtuar vëmendje rëndësisë së EFL ose Anglisht si një Medium i Udhëzimit (EMI) në nivelin Parafillor. Për momentin, janë botuar relativisht pak hulumtime në dispozicion për të mbështetur mësuesit, hartuesit e politikave dhe familjet që mësojnë gjuhën angleze përmes ECEC në Evropë (Mourão dhe Lourenço, 2015). Më shumë hulumtime në këto fusha do të na ndihmojnë të përvetësojmë një qasje më të unifikuar, të bazuar në një kuptim të përbashkët, i cili do të mundësonte zhvillimin e një sërë udhëzimesh për sa i përket edukimit të mësuesve, trajnimit gjatë shërbimit dhe hartimi i kurrikulave, ndër çështjet e tjera. Ne i presim vitet e ardhshme ku shpresojmë se do të shohim zhvillime më të mëdha në këto fusha të rëndësishme.

E njëjta temë është mirë të hulumtohet sërish por me një mostër më madhe të mësueseve, në mënyrë që të dalin rekomandime të reja që do të shfrytëzohen për ngritje të cilësisë së Edukimit Parashkollor në Kosovë dhe zbulimin e metodave e praktikave më efektive dhe të përshtatshme për mësimnxënien e Gjuhës Angleze.

LITERATURA

Alcon, E and Guzman, J-R (2000). *Language learning Strategies and Second language Use in academic Context. Universtate Jaume I.*

Asher, J. (2007). *TPR: After forty years, still a very good idea.* Retrieved on 10 July 2013 from: <http://www.tpr-world.com/japan-article.html>

Barzco, B. (2008). *Introducing English as a foreign language in preschool situations.* Berlin: VDM Verlag Dr. Muller.

Borich, G.D. (2007). *Effective teaching methods “research- based practice”.* Ohio: Pearson Education Inc.

Barnett, WS and Hustedt, JS (2003) Pre-school: *The most important grade. The First Years of School*, 60(7), 54-57.

Cameron, L. (2003). *Challenges for ELT from the expansion in teaching children. ELT Journal*, 57(2), 105–112.

Curtain, H. & A. Dahlberg (2010). *Languages and Children, Making the Match: New Languages for Young Learners, Grades K-8.* Boston: Pearson Education Inc.

Curtain, H. & Dahlberg, C. A. (2010). *Languages and children – Making the match: New languages for young learners, 4th ed.* Boston, MA: Pearson

Crain, W. (2005). *Theories of development: Concepts and Applications .New Jersey: Pearson*

Dunn, O. (2011). *How young children learn English as another language.* Retrieved January 23, 2016, from *Learn English Kids:* <http://learnenglishkids.britishcouncil.org/en/parents/articles/how-young-children-learn-english-another-language>

Felder,R. M. & Brent, R. (2007) *Cooperative Learning, in Mabrouk, P. A., ed., Active Learning: Models from the Analytical Sciences, ACS Symposium Series 970, Chapter 4.* Washinton, DC: American Chemical Society.

Felder,R. & Brent, R . (2012). *Coperative learning*

Harfield, J. (1999). *Beginners' Communication Games.* Longman

J. K. & Crandall, J. A. (2014). *Teaching young learners English: From theory to practice.* Boston, MA: National Geographic Learning/Cengage Learning.

Kirkpatrick (2011) *English as a medium of instruction (prom primary to tertiary):Implication for local language and local scholarship .applied Linguistics Review,vol.2011,p99-119.*

- Krashen, S.(1982) *Principles and Practice in Sekond Language Acquisition*.Oxford\New York:Pergamon Press Inc.
- Kumaravadivelu,B (1994). *Intake factors and intake process in adult language learning*Applied language learning. 5:33-71.
- LaRock. H.,(2019). *Disadvantages of Studying a New Language in Kindergarten . The Classroom*
- Larsen-Freeman, D. (2004). *Teachniques and Principles in Language Teaching*. Oxford: Oxford University Press
- Marzano, R. J. (2010, February). *The Art and Science of Teaching / Using Games to Enhance Student Achievement*. Retrieved January 22, 2016, from ASCD: *Educational Leadership*:
<http://www.ascd.org/publications/educational-leadership/feb10/vol67/num05/Using-Games-to-Enhance-Student-Achievement.aspx>
- Mourão, S and Lourenço, M (eds) (2015) *Early years second language education: International perspectives on theory and practice*. London: Routledge
- Menzel, R. (2013) *Learning, Memory and Cognition: Animal Perspectives*. In *Neurosciences – From Molecule to Behaviour: A University Textbook* (Galizia, C.G. and Lledo, P.-M., eds), pp. 629-653, Springer-Verlag
- Murphy, V. A. &Evangelou, M. (Eds.) (2016). *Early childhood education in English for speakers of other languages*. London: British Council.
- Mrutu, N., Rea-Dickins, P., Bakuzza, F., &Walli, S. (2016). *Beyond ABC: the com-plexities of early childhood education in Tanzania*
- Melhuish, E, Erekly-Stevens, K, Petrogiannis, K, Ariescu, A, Penderi, E, Rentzou, K, Tawell, A, Leseman, P and Broekhuisen, M (2015) *A review of research on the effects of early childhood Education and care (ECEC) on child development* <http://ecec-care.org/resources/publications>
- Morley, J. (2001). *Aural Comprehension Instruction: Principles and Practices*. In *CelceMurcia, M. (Ed.) Teaching English as a Secoind or Foreign Language, 3rd edition, 69-85*. Boston: Heinle Cengage Learning.
- Pinter, A. (2006). *Teaching young languge learners*. Oxford: Oxford University Press
- Richards, J. C., & Rodgers, T.S. (2001). *Approaches and methods in language teaching*. USA: Cambridge University Press
- Rosembuch (1995). *Guidelines for Starting an Elementary Foreign Language Program*. National K-12 Foreign Language Resource Center, Iowa State University. Retrieved from <http://www.cal.org/resources/digest/rosenb01.html>

Ross, J. and Smythe, E. (1995) *Differentiating Cooperative Learning to Meet the Needs of Gifted Learners: A Case for Transformational Leadership*. *Journal for the Education of the Gifted*, 19, 63-82.

<http://dx.doi.org/10.1177/016235329501900105>

Scott, W., & Ytreberg, L. H.. (1990). *Teaching English to children*. London: Longman

Stipek, D and Ryan R (1997) *Economically disadvantaged pre-schoolers: Ready to learn but further to go*. *Developmental Psychology*, 33, 711-723

Shankar, P. & Gunashekar, P. (2016). *Early childhood education in English in India*

V. Murphy & M. Evangelou, *Early childhood education in English for speakers of other languages (pp. 43–56)*. London: British Council.

Wichadee, S.(2005). *The effects of corporative learning on English reading skill and attitudes of the first year students as Bangkok University*. *Bu academic review*

https://www.researchgate.net/publication/324227592_Current_issues_in_learning_English_as_a_foreign_language_at_preschool_Challenges_and_prospects

<https://www.theclassroom.com/disadvantages-studying-new-language-kindergarten-9805.html>

https://timssandpirls.bc.edu/pirls2016/questionnaires/downloads/P16_TQ.pdf

https://www.researchgate.net/publication/281407038_THE_TEACHERS'_EDUCATIONAL_PRACTICES_QUESTIONNAIRE_DEVELOPMENT_OF_A_NEW_SELF-EVALUATION_INSTRUMENT_FOR_TEACHERS

https://www.researchgate.net/publication/273852514_Teaching_English_to_Pre-school_Children

https://www.teachingenglish.org.uk/sites/teacheng/files/pub_F240%20Early%20Childhood%20Education%20inners%20FINAL%20web.pdf (faqe 15-16) (Faqe 72).

<http://ket-net.org/page/about/>

SHTOJCAT

SHTOJCA A FORMULAR PAJTIMI



UNIVERSITETI I MITROVICES
'ISA BOLETINI'
Rr.Parku Industrial, p.n. 40000 Mitrovicë
Republika e Kosovës
FAKULTETI I EDUKIMIT

FORMULAR PAJTIMI

I/E nderuar,

Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Mitrovicës, në organizimin e studimeve ka të paraparë zhvillimin e punimit të diplomës. Në këtë kuadër, unë kam zgjedhur të zhvilloj këtë hulumtim: "Metodat efektive të mësimnxënies së gjuhës angleze te fëmijët parafillor në komunën e Vushtrrisë"

Formulari ju ofrohet për tu pajtuar që të jeni pjesë e hulumtimit. Ne ju sigurojmë që të dhënat e mbledhura në këtë studim, do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të këtij studimi. Ju mund të zgjidhni të jeni pjesëmarrës në kushte anonimiteti ose konfidencialiteti. Ne respektojmë zgjedhjen tuaj.

Duke besuar dhe respektuar në bashkëpunimin me ju, ju falënderojmë.

Ju lutem nënshkruani konfirmimin tuaj.

Ofruesi i formularit

Një kopje e këtij konfirmimi mbetet tek ju.

[Nëse keni ndonjë pyetje apo paqartësi në vazhdimësi, ju lutem kontaktoni profesoreshën udhëheqëse të punimit, Edita Bekteshi, në edita.bekteshi@umib.net]

Ju faleminderit !



UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

Ky pyetsorë përmban pyetje që kanë lidhje me metodat efektive të mësimnxënies së gjuhës angleze te fëmijët parashkollor. Ju lutem plotësoni të gjitha pyetjet e këtij pyetësori duke dhënë përgjigjet më të sakta për ju. Pyetsori do të përdoret për temë të diplomës dhe përgjigjet e juaja do të jenë anonime dhe konfidenciale. Falemiderit për pjesëmarrjen.

Pyetsorë për mësueset e gjuhës angleze

1. Emri dhe mbiemri (opcionale) _____

2. Gjinia

1. Mashkull

2. Femër

3. Nuk preferoj të përgjigjem

3. Mosha

1. 20-30 vjeq

2. 30-40 vjeq

3. 40-50 vjeq

4. Mbi 50 vjeq

4. Emri i shkollës në të cilën punoni: _____

5. Shkollimi:

1. I mesëm

2. I lartë (BA)

3. I lartë (MA)

4. Doktoraturë

6. Përvoja e punës si edukatore: _____

7. Vendbanimi:

1. Fshat

2. Qytet

• Përgjigjet e pyetjeve më poshtë i rumbullaksoni në numrat që janë paraqitur në tabelë (rumbullaksoni vetëm një përgjigje):

	Gjithmonë	Shpesh	Zakonisht	Ndonjëherë	Asnjëherë
1. Mendoj se metoda e bashkëpunimit është shumë efektive	1	2	3	4	5
2. Përdor oborrin për aktivitete të ndryshme	1	2	3	4	5
3. Fëmijëve u pëlqen të mësojnë anglisht kur bashkebisedojne	1	2	3	4	5
4. Gjatë aktiviteteve unë organizoj punë në grupe	1	2	3	4	5
5. Gjatë ditës jap aktivitete me zgjedhje të lire	1	2	3	4	5
6. Përdor radion si mjet pune					
7. Nga kendveshtrimi im si edukatore, fëmijëve u pëlqejne sfidat gjatë mësimit të gjuhës angleze	1	2	3	4	5
8.U lexoj fëmijëve me zë të lartë	1	2	3	4	5
9. Përdor lavdërime për ti motivuar nxënësit	1	2	3	4	5
10. Praktikoj lloj-llojshmëri metodash brenda një aktiviteti	1	2	3	4	5
11. Une përdor metodën TPR	1	2	3	4	5
12. Unë përdor metodën Gramar Translation	1	2	3	4	5
13. Une përdori literature per ngitjen time profesionale ne gjuhën amtare dhe angleze	1	2	3	4	5
14. T'iu mësoj gjuhën angleze është një sfidë që më pëlqen	1	2	3	4	5
15. Lexoj shumë libra,artikuj,gazeta dhe revista në gjuhën angleze për tu	1	2	3	4	5

pajisur me njohuri të reja që do më duhen në klasë					
16. Marr pjesë në trajnime të ndryshme në gjuhën angleze	1	2	3	4	5
17. Gjatë një aktiviteti unë eci nëpër tavolina për të ndihmuar fëmijët që kanë nevojë për të zhvilluar aktivitetin	1	2	3	4	5

Këtu mbaron pyetëtori. Ju faleminderit!